

# (MOS) REHABILITIMI I ISH TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

Në procesin e drejtësisë tranzicionale  
(1991-2018)



Instituti për Demokraci Media dhe Kulturë (IDMC)



© 2019 Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC)

Adresa: Rr. Bardhok Biba, Hyrja A, Kati 11, Tiranë

Email: [office@idmc.al](mailto:office@idmc.al), [www.idmc.al](http://www.idmc.al)

Të gjitha të drejtat e rezervuara

(Mos)rehabilitimi i ish të përndjekurve politikë

Në procesin e drejtësisë tranzicionale (1991-2018)

Ky studim u përgatit nga Erblin Vukaj gjatë vitit 2018. IDMC nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e publikimit. Përgjegjësia është e autorit.

Redaktore shkencore: Jonila Godole

Ky botim u mbështet nga Fondacioni Konrad Adenauer, Zyra Tiranë

Grafika dhe faqosja: Iceberg Communication

Foto e kopertinës: LSA

Shtypshkronja: Filara

(MOS)REHABILITIMI  
I ISH TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

Në procesin e drejtësisë tranzicionale (1991-2018)

STUDIM

Instituti për Demokraci Media dhe Kulturë (IDMC)  
Tiranë, 2019



# Përmbajtja

	<b>Hyrje .....</b>	<b>7</b>
<b>1.</b>	<b>Një historik i shkurtër i kuadrit ligjor dhe procesit të rehabilitimit të ish-të përndjekurve në Shqipëri ..</b>	<b>9</b>
1.1	Nisja e procesit të rehabilitimit (1991-1997)..	9
1.2	Ndërprerja e procesit të dëmshpërblimeve (1998-2005) .....	12
1.3	Rifillimi i procesit të dëmshpërblimeve (2006-2013) .....	14
1.4	Vazhdimi i procesit rehabilitues me të tjera ndryshime (2014-2018) .....	20
<b>2.</b>	<b>Procesi i rehabilitimit në kuadër të drejtësisë tranzitore .....</b>	<b>24</b>
2.1	Demokracia e re dhe përpjekjet e para për vendosjen e drejtësisë (1991-1997) .....	25
	Vitet e para 1992-1994 .....	25
	Miratimi i ligjeve të para për krimet e regjimit dhe Sigurimin (1994-1997).....	29
2.2	Faza e dytë e drejtësisë tranzicionale (pas vitit 1997) .....	35
<b>3.</b>	<b>Kuadri juridik për drejtësinë tranzitore .....</b>	<b>40</b>
	Ligjet kryesore .....	40
	Ndryshimet ligjore .....	41
	Numri i ish-të përndjekurve dhe aplikimet .....	41
	Kostot ekonomike .....	43
	Kërkesat për hapjen e dosjeve dhe burokracitë institucionale.....	46
<b>4.</b>	<b>Përfundime .....</b>	<b>51</b>
	<b>Rekomandime .....</b>	<b>53</b>
	<b>Referencat .....</b>	<b>54</b>

## **Lista e shkurtimeve**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit  
**AIDSSH**

Instituti për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë  
**IIPP**

Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit  
**ISKK**

Komiteti i ish-të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë  
**KIDPP**

Kontrolli i Lartë i Shtetit  
**KLSH**

Organizata e Kombeve të Bashkuara  
**OKB**

Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Europian  
**OSBE**

Komisionin Ndërkombëtar për Njerëzit e Humbur  
**ICMP**

## Hyrje

Kanë kaluar 28 vite nga rrëzimi i diktaturës në Shqipëri dhe shumë pak është bërë deri më sot për rehabilitimin e ish të përndjekurve, viktimave të persekutimit të regjimit komunist. Sipas Konventës së OKB kundër “Torturës dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese *“rehabilitimi i viktimave duhet të synojë të rivendosë, për aq sa është e mundur, pavarësinë, aftësinë fizike, mendore, sociale dhe profesionale si dhe përfshirjen dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri”*<sup>1</sup>. Në këtë studim, procesi i rehabilitimit do të kufizohet në shpërbllimin dhe kompensimin financiar për viktimat, bazuar në kuadrin ligjor në Shqipëri për këtë proces në periudhën kohore 1991 – 2018.

Në pjesën e tij të parë, studimi e trajton procesin e rehabilitimit të ndarë në katër faza kohore dhe zhvillimesh ligjore: Faza e parë, nisja e procesit të rehabilitimit 1991-1997; Faza e dytë, ndërprerja e procesit të dëmshpërblimeve 1998-2005. Faza e tretë, rifillimi i procesit të dëmshpërblimeve (2006-2013), dhe faza 2014–2018 e në vazhdim. Punimi synon të prezantojë hapat e parë në këtë proces, si ligji mbi pafajësinë, mbi rehabilitimin dhe format e dëmshpërblimit, por edhe ndryshimet ligjore që shoqëruar më së shumti me protesta dhe greva nga ish të përndjekurit.

Pjesa e dytë e studimit përpiqet të analizojë kuadrin ligjor në raport me pritshmëritë e një drejtësie tranzicionale që pritej të vendosej në vendet ish komuniste. Këtu do të fokusohemi kryesisht në dy faza, në ndryshimet fillestare gjatë periudhës 1991-1997 dhe pas vitit 1997.

Në pjesën e tretë, studimi paraqet kuadrin juridik për drejtësinë tranzicionale, ku përforcohen boshllëqet e këtij procesi në lidhje

---

1. Komiteti i Kombeve të Bashkuara kundër Torturës (CAT), Komenti i Përgjithshëm nr. 3, 2012, “Convention Against Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment”. Zbatimi i nenit 14, 13 dhjetor 2012, online në <https://www.refworld.org/docid/5437cc274.html>

me probleme të tilla si numri i kontestuar i ish të përndjekurve, dëmshpërblimet dhe kompensimet, si dhe kërkesa për hapjen e dosjeve. Gjithë këto vite, pavarësisht hapave pozitivë me krijimin e institucioneve si Komiteti i ish-të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë (KIDPP) më 1993, Instituti për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë (IIPP) më 1997, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKK) më 2010 dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) më 2015, rehabilitimi i ish të përndjekurve nuk i ka përmbushur pritshmëritë e tyre dhe të shoqërisë shqiptare.

Shkurtimisht mund të themi, se ky studim nuk paraqet vetëm një përmbledhje të zhvillimeve ligjore në lidhje me procesin e rehabilitimit të ish të përndjekurve politikë. Por ai paraqet edhe një analizë të zhvillimeve të rëndësishme që ndikuan ndër vite procesin më të vështirë të demokracisë shqiptare: Përballjen me krimet e diktaturës dhe rehabilitimin e të gjithë personave që vuajtën padrejtësisht në regjimin komunist. Teza kryesore e këtij studimi është se tejzgjatja e procesit të rehabilitimit të viktimave ndikon jo vetëm në jetët e ish të përndjekurve, por edhe në zgjatjen e tranzicionit politik. Problematikat që kanë vështirësuar mbarëvajtjen e këtij procesi, mosdënimi i krimeve dhe mosrespektimi i viktimave, vë në dyshim vlerat demokratike që klasa politike dhe shoqëria e një vendi ndan kundrejt shteteve të Bashkimit Europian ku ne synojmë të antarësohemi.



# 1. NJË HISTORIK I SHKURTËR I KUADRIT LIGJOR DHE PROCESIT TË REHABILITIMIT TË ISH-TË PËRNDJEKURVE NË SHQIPËRI

## 1.1 Nisja e procesit të rehabilitimit (1991-1997)

Parlamenti i parë pluralist, i dalë nga zgjedhjet e 31 marsit 1991 në Shqipëri, nisi një *“program pajtimi kombëtar”* duke u dhënë pafajësinë të gjithë të burgosurve dhe të përndjekurve politikë të sistemit komunist. Kjo u bë më 30 shtator 1991 përmes miratimit të **“Ligjit nr. 7514 Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”**. Me këtë ligj, qeveria e asaj kohe, e ashtuquajtur e “Stabilitetit”, kryesuar nga Ylli Bufi, zotohej të merrte *“të gjitha masat që të kompensonte dhe rehabilitonte ata, të cilët qenë akuzuar, gjykuar, dënuar e burgosur, internuar apo përndjekur padrejtësisht për shkelje të natyrës politike”*. Synimi ishte reformimi ligjor dhe vendosja e një shoqërie të lirë dhe demokratike.

Në 45 vite diktaturë komuniste – *për çështje politike* – u pushkatuan mbi 5 500 persona, mbi 14 mijë të tjerë u burgosën, ndërsa numri i të internuarve ishte edhe më i madh. Këto shifra<sup>2</sup> flasin qartë për terrorin që prodhoi regjimi i diktatorit Hoxha.

Më 4 janar 1992 qeveria teknike e kryesuar nga Vilson Ahmeti udhëzoi me vendimin Nr. 2 të po asaj date, zbatimin e mëtejshëm të *“ligjit të pafajësisë dhe rehabilitimit”*. U pa e nevojshme krijimi i një institucioni qendror shtetëror që do të koordinonte punën e grumbullimit të informacioneve. Qeveria që erdhi më pas, e kryesuar nga Aleksandër Meksi, krijoi nga janari 1993 deri në dhjetor 1994, Komitetin e ish-të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë (KIDPP). Në këtë periudhë *“ligji për pafajësinë dhe rehabilitimin e ish-të*

---

2. IIPP, Statistika mbi ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë; <http://ishperndjekurit.gov.al/al/statistika/>

përndjekurve” u ndryshua tre herë<sup>3</sup> me propozime nga mazhoranca. KIDPP me rreth 120 specialistë në të gjithë rrethet, grumbulloi të dhënat që identifikuan të përndjekurit. Parlamenti ndërkohë miratoi **Ligjin Nr.7748 datë 29.07.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”**. Ky ligj përcaktoi kriteret dhe kushtet themelore se kur një person mund të konsiderohej “i dënuar apo i përndjekur politik” si dhe të drejtat e detyrimit që pasonin prej tij në përputhje me shkallën e persekutimit. *“Persekutim politik” apo “përndjekje” u vendos të quhej “çdo veprim ose mosveprim i kryer që nga data 8.11.1941 deri më datën 22.3.1992 nga ana e strukturave shtetërore me urdhër ose vendim të organeve partiake, kur ky veprim ose mosveprim ka shkaktuar humbjen e jetës, lirisë, të drejtave qytetare, si dhe çdo privim tjetër”*<sup>4</sup>

Në prill të vitit 1994, nën një trysni të fortë sa politike, po aq edhe sociale, ish-të përndjekurit politikë, nën organizimin e shoqatës së ish-të përndjekurve kryesuar nga Kurt Kola, hynë në grevë. Rreth 180 persona kërkuan të respektoheshin të drejtat që u ishin garantuar me ligj dhe të niste sa më parë procesi i kompensimeve. Në përkrahje të tyre doli edhe deputeti i atëhershëm i Partisë Demokratike, Azem Hajdari.

Rreth një muaj më vonë, më 4 maj 1994<sup>5</sup>, qeveria vendosi të nisë kompensimin që u procedua përmes të dhënave të KIDPP pasi kishte përcaktuar *“statusin”* e të përndjekurve. Sipas ligjit, vitet e dënimit politik u njohën si vite pune për efekt pensioni. Një vit burg u barasvlerësua me dy vjet punë dhe koha e burgut u njoh si punë e rëndë. Nga ana tjetër,

3. Ligji nr. 7514 i datës 30.09.1991 “Për pafajësinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politik” u ndryshua tre herë nga Qeveria Mexsi, fillimisht më 14 janar 1993 me Ligjin nr. 7660; më 8 qershor 1993 me ligjin nr. 7719 dhe 7 dhjetor 1993 me ligjin nr. 7772.

4. Neni 2, Ligji Nr.7748 datë 29.07.1993 “Për Statusin e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë nga Sistemi Komunist” <http://ishperndjekurit.gov.al/al/wp-content/uploads/2015/03/Ligj-stat.-e-te-perndjekurve-politike-7748-DT-04.08.1993.pdf>

5. Vendimi nr. 184 datë 04.05.1994 “Për dhënien e Kompensimit Pasuror ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë nga Sistemi Komunist” <https://bit.ly/2SK0w9J>

çështjet e strehimit, punësimit, kualifikimit dhe edukimit për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë, u konsideruan si prioritare.

Për rreth tre vite, KIDPP arriti të përmbyllë një pjesë të procedurave të dhënies së statusit. Gjatë kësaj kohe, deri në dhjetor 1997, kompensimi pasuror u bë kryesisht me **“letra me vlerë”**<sup>6</sup> – të cilat u zhvlerësuan pothuajse plotësisht – dhe një pjesë e vogël me para në dorë. Rreth 15 vite më vonë, Simon Mirakaj, atëkohë drejtor i Institutit të ish të Përndjekurve Politikë (2002-2013), do të deklaronte se *“në vitin 1994 u dha një dëmshpërblim me letra me vlerë, ku një vit burg u vlerësua me 1,2 milionë lekë (të vjetra) letra me vlerë dhe në bazë të viteve të burgut dhe moshës u dha një sasi lekësh në dorë. Të pushkatuarve iu ‘ndanë’ tetë vjet letra me vlerë (9.6 milionë të vjetra) dhe 2 milionë lekë (të vjetra) dëmshpërblim”*<sup>7</sup>.

Por kjo mënyrë dëmshpërblimi përhapi mjaft skepticizëm, pasi letrat me vlerë u zhvlerësuan menjëherë dhe shumë pak prej tyre mund të përdoshin. Në gjuhën popullore ato u konsideruan ironikisht si “letra me vrimë”<sup>8</sup>.

Nga të dhënat e Institutit të Integritimit të ish të Përndjekurve Politikë (IIPP), për ish-të përndjekurit në atë periudhë u shpërndanë 17,5 miliardë lekë në bono privatizimi që sipas Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) në pjesën më të madhe ishte një shumë fiktive. Vlera e tyre reale u ul në 3-5%, vlerë simbolike. Nga bonot e shpërndara u përdorën vetëm 40% e tyre duke u shitur në një vlerë shumë më të ulët se sa vlera që kishin. Sipas KLSH shumata reale në letra me vlerë ishte vetëm

6. Bono privatizimi (ose lekë privatizimi) të konvertueshme në aksione, në kapitale të pjesshme ose tërësore të shtypura nga Banka e Shqipërisë dhe shpërndarë nga Banka e Kursimeve pas miratimit të dekretit nr.1030, datë 23.02.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)”.

7. Top Channel; “Top Story”: Ish të përndjekurit përballë politikës. 8 mars 2012; <http://top-channel.tv/2012/03/08/top-story-ish-te-perndjekurit-perballe-politikes/>

8. Erebara, Gjergj (2012, 10 tetor). “Qeveria i konverton letrat me vlerë në lekë, jo sa vlejné në treg”. Gazeta Shqip. <http://gazeta-shqip.com/lajme/2012/10/10/qeveria-i-konverton-letrat-me-vlere-ne-leke-jo-sa-vlejne-ne-treg/>

7,6 miliardë lekë (7 614 705 000), shumë kjo totalisht e zhvlerësuar<sup>9</sup>.

Edhe pse kishte nisur procesi i kompensimit, ish-të përndjekurit hynë sërish në grevë. Në muajin gusht 2 500 ish-të burgosur nisën një grevë urie, e cila nga qeveria u konsiderua “me qëllime destabilizuese për vendin”<sup>10</sup>. Nuk pati konfirmime zyrtare, por sipas Kurt Kolës, asokohe kryeatar i shoqatës së ish-të përndjekurve “policia ndërhyri për të shpërndarë protestuesit”<sup>11</sup>.

### ***Të rëndësishme!***

- 30 shtator 1991 – miratohet Ligji për “Pafajësinë, Amnistinë dhe Rehabilitimin e ish-të Përndjekurve Politikë”
- 29 korrik 1993 – miratohet Ligji për “Statusin e ish-të Përndjekurve”
- 4 maj 1994 – nis procesi i dëmshpërblimit për vuajtjet e shkaktuara ndaj të përndjekurve politikë. Vitet e dënimit politik u njohën si vite pune për efekt pensioni. Një vit burg u barasvlerësua me dy vjet punë dhe koha e burgut u njoh si punë e rëndë.

## **1.2 Ndërprerja e procesit të dëmshpërblimeve (1998-2005)**

Gjatë qeverisë Nano, parlamenti strukturoi me **Ligjin nr. 8246, datë 1 tetor 1997 “Institutin e Integritit të të Përndjekurve Politikë”** (IIPP) që do të kishte si qëllim “marrjen e të gjitha masave dhe ndjekjen e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me integritimin në jetën e shoqërisë

---

9. KLSH (2016, qershor). Raport Auditimi i Performancës “Rehabilitimi i ish-të Përndjekurve Politikë në Periudhën e Tranzicionit”, fq. 41.

10. Dhimgjoka, Merita (1994, 5 gusht). Former Political Prisoners Fasting for Compensation. Associated Press. <https://www.apnews.com/7a4e596416c42ca7d0bad07dd1bed874>

11. Po aty.

*shqiptare të ish-të përndjekurve politikë nga regjimi komunist*". Por IIPP u mor kryesisht me përfundimin e listës emërore të personave që do të gëzonin statusin dhe do të nisnin më pas edhe të dëmshpërbleheshin. Lista përfundimtare<sup>12</sup> e organizuar në pesë kategori: të pushkatuarit politikë (5 548), të sëmuret mendorë (273), të burgosurit politikë (14 563), të burgosurit politikë të vdekur në burgje (987) dhe të internuarit apo të dëbuarit politikë (21 401) – **kapi numrin total 42 772** persona.

Pavarësisht ligjit të miratuar që në vitin 1993 dhe vendimit të qeverisë Meksi në vitin 1994 për kompensimin, procesi u zvarrit dhe u ndërpre tërësisht në periudhën 1998-2006. Sipas KLSH **në periudhën 1993-1997, qeveritë shpërndanë për ish-të përndjekurit 2.2 miliardë lekë**<sup>13</sup> (rreth 17.5 milionë euro<sup>14</sup>).

Gjatë viteve 2002-2005 propozimet e ish të përndjekurve për një projekt-ligj të ri për dëmshpërblimin e viteve të burgimit u hodhën vazhdimisht poshtë nga qeveria e asaj kohe si të papërbalueshme. *"Kompensimi që ata (ish-të përndjekurit) kërkojnë shkon deri në 1.2 miliardë dollarë, shumë kjo e pa-arritshme nga buxheti i Shtetit"*<sup>15</sup> shprehej Arben Malaj Ministër i Financave. Qeveria socialiste *"propozonte pension mujor prej 50 dollarësh"*<sup>16</sup> gjë që nuk pranohej nga ish-të përndjekurit pasi me ligjin e vitit 1994 atyre "u jepte 30 dollarë për çdo ditë burg"<sup>17</sup>. Përplasjet ishin të pashmangshme.

Ish të-përndjekurit protestuan përpara Parlamentit dhe Kryeministrit. Situata u acarua nga ndërhyrjet e dhunshme të policisë

12. IIPP, Statistika mbi ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë; <http://ishperndjekurit.gov.al/al/statistika/>

13. KLSH (2016, qershor). Raport Auditimi i Performancës "Rehabilitimi i ish-të Përndjekurve Politikë në Periudhën e Tranzicionit", fq. 15.

14. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në periudhën gusht 2018, 1 Euro këmbuhej me 125.51 lekë.

15. Prodger, Matt (2004, 23 korrik). Albania seeks to compensate political prisoners. BBC. <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/3917293.stm>

16. Po aty.

17. Po aty.

ndaj tyre, situatë kjo që detyroi Presidentin Alfred Moisiu të thërriste në janar 2003 një mbledhje me përfaqësues të lartë të qeverisë. Megjithëse u premtua ngritja e një komisioni për të shqyrtuar të gjitha kërkesat e ish-të përndjekurve, asgjë nuk e zhbllokoi procesin e ndërprerë që prej vitit 1997.

### ***Të rëndësishme!***

- *1 tetor 1997 – krijohet IIPP, i cili përpiloi dhe listën përfundimtare të të përndjekurve nga regjimi komunist, të cilët mund të gëzonin statusin. Numri i tyre kapi shifrën 42 772 persona.*
- *1998-2006 – procesi i kompensimit të ish të përndjekurve u ndërpre.*

### **1.3 Rifillimi i procesit të dëmshpërblimeve (2006-2013)**

Qeveritë Nano-Meta-Majko-Nano u pasuan nga qeveria Berisha që pati premtuar në programin e saj zgjidhje të situatë së ish të përndjekurve. Më 30 tetor 2006, Parlamenti miratoi një nga dy<sup>18</sup> rezolutat e vetme në historinë e tranzicionit shqiptar mbi dënimin e krimin komunist. **Rezoluta “Për dënimin e krimeve të regjimit komunist në Shqipëri”** vlerësoi se *“viktimat e krimeve të regjimit meritojnë respekt, mirënjohje dhe mirëkuptim për vuajtjet e tyre”*<sup>19</sup>. Për këtë u kërkua

18. Rezoluta e dytë, po me propozim të demokratëve, do të miratohej 10 vite më vonë dhe do të ishte “Për dënimin e krimeve të komunizmit ndaj klerit, si dhe mirënjohjen e vecantë për rolin dhe veprimtarinë e klerikëve në mbrojtjen e vlerave demokratike dhe të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” 3 nëntor 2016.

19. Rezoluta “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri”, Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr.117, 15 nëntor 2006, fq.4 [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2006/PDF-2006/117-2006.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2006/PDF-2006/117-2006.pdf)

përmbushja e të gjitha detyrimeve ligjore lidhur me statusin e të përndjekurve politikë për integrimin, arsimimin, punësimin, strehimin dhe dëmshpërblimin e tyre në një kohë sa më të shpejtë.

Në pikat 10 dhe 11 të rezolutës u kërkua hapja e dosjeve të ish-bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Shtetit, publikimi i të gjitha dokumenteve që dëshmojnë krimet e regjimit komunist, përfshirë edhe dosjet e krijuara në ish-institucionet e përndjekjes. Në pikën 16, rezoluta nxiste fillimin e një fushate kombëtare për ndërgjegjësimin rreth krimeve të kryera në emër të ideologjisë komuniste, konkretisht *“rishikimin e librave shkollorë, shpalljen e një dite kombëtare për përkujtimin e viktimave të komunizmit, hapjen e muzeve, përfshirë edhe kthimin në muze të burgjeve të tmerrshme politike, si dhe ngritjen e memorialeve në nderim të shqiptarëve që u vranë për kundërvënien ndaj regjimit totalitar”*.<sup>20</sup> Gjithashtu rezoluta, me pikën 12, ftonë të gjitha partitë *“komuniste dhe postkomuniste që të rikonsiderojnë historinë e komunizmit dhe të kaluarën e tyre duke u distancuar qartësisht nga krimet e kryera nga regjimi komunist dhe diktatori Enver Hoxha”*.<sup>21</sup>

Në vitin 2007 qeveria Berisha rinisi sërish procesin e dëmshpërblimeve të ish-të përndjekurve duke propozuar e miratuar **Ligjin nr. 9831 datë 12 nëntor 2007, “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”** ku u ripërcaktuan shpërblimet, por edhe përfituesit. Ish-të përndjekurit me “status” u ftuan të aplikojnë. Sipas ligjit çdo ish-i burgosur do të dëmshpërblehej me *“2 000 lekë për çdo ditë burg”*<sup>22</sup>, ndërsa për ata të cilët regjimi i internoi në kampet me rrethim me tela deri në vitin 1954, dëmshpërblimi do të ishte me *“1 mijë lekë në ditë”*. Dëmshpërblimet do të ndaheshin në 8

20. Po aty.

21. Po aty.

22. “Masa e dëmshpërblimit për të burgosurit, të internuarit ose të dëbuarit”, Neni 6 i Ligjit Nr. 9831 datë 12.11.2007; Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 160 datë 3 dhjetor 2007 fq.4 [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2007/PDF-2007/160-2007.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2007/PDF-2007/160-2007.pdf)

këste dhe u vendos se do t'i jepej edhe familjarëve në rastet kur ish-të përndjekurit nuk jetojnë më.

Ndërkohë, KLSH në raportin e tij, vë në dukje se ndryshe nga ligji i vitit 1993 “Për statusin”, ligji i vitit 2007 “Për dëmshpërblimet” (bashkë me ndryshimet e mëvonshme të viteve 2009, 2014 dhe 2017) parashikon dëmshpërblim financiar nga data 30 nëntor 1944 deri më 1 tetor 1991 dhe jo – sikurse merr për bazë ligji i vitit 1993 “Për statusin” prej 8 nëntorit 1941, duke lënë jashtë procesit të kompensimit sidomos përndjekjet gjatë “luftës vëlla-vrasëse” që nxiti prishja e marrëveshjes së Mukjes më 2 gusht 1943. Më saktësisht janë lënë jashtë procesit 457<sup>23</sup> raste ish-të përndjekurish ku (kryesisht familjarët e tyre) kanë aplikuar për t’u kompensuar, por që sipas ligjit të vitit 2007 nuk përfitojnë.

Për t’u rikthyer rrjedhës kronologjike, shpërndarja e shpërblimeve nisi në vitin 2009. Gjatë kësaj periudhe u krijua një tjetër institucion i rëndësishëm për përballjen me të shkuarën. Më 25 shkurt 2010, me “**Ligjin Nr. 10.242**” u krijua **Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK)**. Instituti u ngarkua të studiojë dhe dokumentojë krimet e kryera nga organet e diktaturës, studime që më vonë do të deklaronin dyfishin e numrit të të përndjekurve politikë në raport me shifrat e IIPP. Sipas raportit<sup>24</sup> të vitit 2016 të ISKK, të përndjekurit nga regjimi komunist mendohet të kenë qenë rreth 100 mijë persona. Nëse marrim të saktë këtë numër dhe provojmë të hamendësojmë edhe shtrirjen me forma të ndryshme të përndjekjes edhe te familjarët e tyre (prindër/fëmijë; vëllezër/motra) atëherë përfundimi do të ishte një numër dyfish apo trefish më i madh se ai i raportuar nga IIPP.

Të dhënat e këtij raporti ISKK i referon në faqen e saj zyrtare në version grafik:

23. KLSH (2016, qershor). Raport Auditimi i Performancës “Rehabilitimi i ish-të Përndjekurve Politikë në Periudhën e Tranzicionit”, fq. 35.

24. ISKK (2016, 28 mars). Raporti vjetor. 6 mijë të vrarë gjatë diktaturës, 34 mijë të burgosur. *Gazeta Panorama*. <http://www.panorama.com.al/raporti-6-mije-te-vrare-gjate-diktatures-34-mije-te-burgosur/>





*Figura 1 - Sipas ISKK numri i shqiptarëve që u internuan nga regjimi ishte 59 009 persona. Burimi [www.iskk.gov.al](http://www.iskk.gov.al)*



*Figura 2 - Sipas ISKK numri i shqiptarëve që u burgosën gjatë diktaturës ishte 34 135 persona. Burimi [www.iskk.gov.al](http://www.iskk.gov.al)*



*Figura 3 - Sipas ISKK numri i shqiptarëve që u vranë gjatë diktaturës ishte 6 027 persona. Burimi: [www.iskk.gov.al](http://www.iskk.gov.al)*



Figura 4 - Sipas ISKK numri i shqiptarëve që vdiqën burgjeve gjatë regjimit komunist ishte 984. Burimi: [www.iskk.gov.al](http://www.iskk.gov.al)



Figura 5 - Sipas ISKK 308 persona humbën aftësitë mendore duke u izoluar në burgje gjatë komunizmit. Burimi: [www.iskk.gov.al](http://www.iskk.gov.al)

Kriza globale ekonomike që përfshiu vendin në atë periudhë, nxiti qeverinë Berisha të ndryshonte procedurat e shpërblimeve duke i kthyer ato me tetë këste. Por vështirësitë financiare me të cilat përballej qeveria Berisha në vitet 2011-2012 bënë që pagesat e kësteve të dyta të ndërpriteshin për një pjesë të konsiderueshme ish-të përndjekurish. Ndërsa për disa të tjerë u abuzua me vlerësimin e “letrave me vlerë” të shpërndara në mesin e viteve 1990, ku shpesh ato u përllogaritën me një kurs fiks “1 lek vlerë nominale e bonos së privatizimit e barabartë me 1 lek kesh [në dorë]”<sup>25</sup> në një kohë kur bonot e privatizimit ishin zhvlerësuar totalisht që në vitet 1996-1999. Për rrjedhojë, qeveria i konsideronte

25. Erebara, Gjergj (2012, 10 tetor). “Qeveria i konvertonte letrat me vlerë në lekë, jo sa vlejnin në treg”. Gazeta Shqip. <http://gazeta-shqip.com/lajme/2012/10/10/qeveria-i-konvertonte-letrat-me-vlere-ne-leke-jo-sa-vlejne-ne-treg/>

disa raste “gjysmë-të shpërblyera”. Për këtë gjendje të krijuar, më 21 shtator 2012 rreth 20 ish-të burgosur politikë hynë në grevë urie. Qeveria e konsideroi grevën politike dhe të shtyrë nga Partia Socialiste që ishte në opozitë. Në një konferencë për shtyp, Kryeministri Berisha do të shprehej se “nuk negocionte me grevistët”<sup>26</sup>, pasi sipas tij “ata i kishin marrë paratë”.<sup>27</sup> Qeveria këmbënguli se i qëndronte angazhimeve të saj për të dëmshpërblyer ish-të përndjekurit dhe tha se nga 11 mijë dosje secili rast kishte marrë këstin e parë. Berisha pretendoi në daljen për shtyp se “kishte bërë një kategorizim” pas vetë propozimeve që kishin ardhur nga ish-të përndjekurit, që “përparësi të kishin për të marrë këstet rastet ku të përndjekurit ishin të moshuar mbi 65-vjeç”<sup>28</sup> ndërsa nga ana tjetër u tha se po punohej që atyre të moshës “mbi 85-vjeç t’u jepet e gjithë shuma e dëmshpërblimit”<sup>29</sup>.

Katër ditë më vonë, më 8 tetor 2012, Gjergj Ndreca (50-vjeç), baba i katër fëmijëve, do të vetë-digjej në shenjë proteste. Më 10 tetor 2012, kur opinionioni publik nuk e kishte marrë ende veten nga kjo ngjarje tronditëse, të njëjtën gjë bëri edhe Lirak Bejko, 47-vjeç. Me më tepër plagë të marra, ai do të ndërronte jetë<sup>30</sup> pak javë më vonë duke sensibilizuar edhe komunitetin ndërkombëtar që kërkoi zgjidhjen e menjëhershme të kësaj situatë. Bejko, në kohën e diktaturës kishte vuajtur 7 vite burg për “tentativë arratisje”. Ai si dhe grupi prej 20 protestuesve të tjerë kishin marrë vetëm një nga tetë këstet e dëmshpërblimeve.

---

26. N.N. (2012, 4 tetor). Berisha: Nuk bëj negociata me ish-të përndjekurit. Akuzat për trafik armësh, trillime. *Gazeta Shqip* <http://gazeta-shqip.com/lajme/2012/10/04/berisha-nuk-bej-negociata-me-ish-te-perndjekurit-rama-do-pazare/>

27. Po aty.

28. Po aty.

29. Po aty.

30. N.N. (2012, 2 nëntor). Albania ex-dissident dies after self-immolation protest. *BBC*. <https://www.bbc.com/news/world-europe-20189444>

Për të lexuar më tej, lutemi të kontaktoni me  
*Institutin për Demokraci, Media dhe Kulturë*

**[www.idmc.al](http://www.idmc.al)**

## 4. PËRFUNDIME

Gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri, neglizhenca, burokracitë dhe lufta politike bënë që në tërësi ligjet që parashikonin rehabilitimin e ish-të përndjekurve të mos miratoheshin në kohën e duhur dhe të mos zbatoheshin plotësisht. Një pjesë e ligjeve nuk u shoqëruan me akte nënligjore dhe për këtë arsye rehabilitimi i ish-të përndjekurve nuk u arrit plotësisht, duke bërë që procesi të zgjatej dhe të mbetet pa një datë përfundimtare.

Procesi i rehabilitimit nisi vetëm në vitin 1993 me ndarjen e dëmshpërblimeve për të ekzekutuarit, vitet e burgimit dhe internimit për ata që u përndoqën. Ky proces u ndalua tërësisht në periudhën 1997-2006 dhe më pas rifilloi, por me ndryshime të tjera në procedura, kohëzgjatje dhe në mënyrën se si do të ndaheshin dëmshpërblimet. Në periudhën e parë u ndanë 2.2 miliardë lekë, ndërsa pas vitit 2006 e deri në vitin 2016 u shpërndanë 16.8 miliardë lekë, për një total prej 19 miliardësh që janë afërsisht 150 milionë euro. Shifra totale për pjesën që mbeten, thuhet se është mbi 257 milionë euro. Edhe pse nuk ka një datë zyrtare, nëse mbahet i njëjti ritëm me të njëjtat alokime fondesh, sipas përlllogaritjeve, nevojitet edhe një dhjetëvjeçar tjetër që procesi i dëmshpërblimeve të përmbyllet.

Prej vitit 2018, dëmshpërblimet nuk mund t'u jepen nipërve dhe mbesave të ish-të përndjekurve që nuk jetojnë më. Në rastet kur familjarët e parë nuk jetojnë më, prej vitit 2018, shumica që u takonte ish-të përndjekurve, i shkon buxhetit të shtetit. Ndërkohë që sot vetëm një në gjashtë të përndjekur mendohet të ketë mbetur gjallë.

Nga ana tjetër, dhe pse ka dy institucione si IIPP apo ISKK që punojnë sa për procesin rehabilitues të ish-të përndjekurve, aq edhe për dokumentimin e përndjekjes së tyre, kur flitet për shifrat përfundimtare – se sa ishte numri i atyre që u përndoqën nga regjimi komunist, – ato raportojnë të dhëna të ndryshme 42 772 persona apo 100 463?!

Bie në sy se pas vitit 1997 nuk ka asnjë të dënuar për krime të kryera në kohën e regjimit komunist. Ende nuk janë gjetur eshtrat e një pjese të madhe të atyre që u pushkatuan me dhe pa gjyq, ndërsa dokumentet e Sigurimit të Shtetit mbeten ende jo të aksesueshme plotësisht. Edhe pse përmes ligjit 45/2015, krijimi i AIDSSH u prit me shpresën se do të hapte dosjet, sot ky proces është tejet burokratik, i përqendruar kryesisht te procedurat e emërimeve të zyrtarëve dhe shumë pak te kërkesat e qytetarëve, studiuesve apo mediave. Si përfundim, krahas problemeve të shumta ligjore, por edhe mungesës së vullnetit dhe transparencës nga politika, Shqipëria vazhdon të ketë në Parlament figura të ish-regjimit komunist dhe ironikisht mbetet në vullnetin e këtyre të fundit për t'u larguar ose jo nga posti.

Ndërkohë ende 28 vite nga ndryshimet e para ligjore në favor të tyre, ish-të përndjekurit vazhdojnë të ngrenë të njëjtat pretendime: Dënimin e krimeve të komunizmit, lustracion të plotë, gjetjen e eshtrave të të pushkatuarve nga diktatura dhe dekomunistizim.

- *Që nga viti 1993 e deri më sot procesi i rehabilitimit të ish-të përndjekurve nuk ka arritur plotësisht objektivin e tij, duke u zgjatur pa një datë përfundimtare.*
- *Deri në vitin 2016 qenë shpërndarë 19 miliardë lekë dëmshpërblime (150 milionë euro) ndërsa mbeten edhe 32,3 miliardë lekë të tjera (257 milionë euro).*
- *Fondet e alokuara për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve nuk i kanë qenë kurrë më shumë se 3 miliardë lekë (viti 2013).*
- *Nmri zyrtar i personave që u përndoqën nga regjimi komunist mbetet në diskutim mes 42 772 apo 100 463.*
- *Asnjë gjyq nuk është mbajtur pas vitit 1997 për të shqyrtuar ndonjë çështje që ka të bëjë me krime gjatë periudhës së regjimit komunist.*
- *Procesi i hapjes së dosjeve, nisur në vitin 2015, nuk ka nxjerrë asnjë krim nga e shkuara komuniste për të cilën ndokush të mbajë përgjegjësi.*

## Rekomandime

Në përfundim të këtij studimi, rekomandimet tona kryesore do të ishin:

- *Ndryshimi i alokimit të fondeve.*
- *Për të përshpejtuar procesin do të duhet që shuma e alokuar për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve të jetë afërsisht sa dyfishi i mesatares që ka qenë vitet e fundit (4.4 miliardë lekë).*
- *Duhet të krijohet një sistem i hapur dhe i saktë i të dhënave për ish-të përndjekurit.*
- *Institucionet që janë ngarkuar me integrimin dhe studimin e rasteve të tyre duhet të nxjerrin shifra të sakta se sa ishte numri i atyre që u përndoqën nga regjimi, pasi me mospërputhjen e shifrave mes IIPP dhe ISKK rezulton se një pjesë shumë e madhe të përndjekurish nuk kanë gëzuar asnjë element nga procesi rehabilitues.*
- *Transparencë totale mbi numrin e ish-të përndjekurve, të cilët ndër vite kanë tërhequr dëmshpërblimet. Ngrihen pyetjet: Sa është numri i atyre që nuk janë dëmshpërblyer dhe sa është numri i atyre që janë ndarë nga jeta pa u dëmshpërblyer? Krijimi i një databaze të të dhënave të personave që i tërhoqën dëmshpërblimet do të ndihmonte procesin.*

## REFERENCAT

### Bibliografi

1. Abdurrahmani, Bledar (2018): Transitional Justice in Albania: The Lustration Reform and Information on Communism Files. In: Interdisciplinary Journal of Research and Development, Vol. 5, no. 3, (fq. 113). AMU: Durrës. <https://www.uamd.edu.al/wp-content/uploads/2017/11/Revista-Durres-nr.3.pdf>
2. Austin C. Robert and Ellison, Jonathan (2009): Albania. In: Lavinia Stan (Ed): Transitional Justice in Eastern Europe and the Former Soviet Union. Reckoning with the communist past. NY: Routledge
3. Imholz, Kathleen (1995). On “decommunization” in Albania. In: East European Constitutional Review, Vol.4, No.3, fq.3 <https://www.ucis.pitt.edu/nceer/1995-808-05-4-Holmes.pdf>
4. Stan, Lavinia (2009): Transitional justice in Eastern Europe and the former Soviet Union: Reckoning with the Communist past. Fq.193. NY: Routledge.
5. Vickers, Miranda and Pettifer, James (1997): Albania: From Anarchy to a Balkan Identity. London: Hurst & Company.

### Burime Online (Gazeta, buletine)

1. <http://gazeta-shqip.com/lajme/2012/10/10/qeveria-i-konverton-letrat-me-vlere-ne-leke-jo-sa-vlejne-ne-treg/>
2. <https://www.apnews.com/7a4e596416c42ca7d0bad07dd1bed874>
3. <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/3917293.stm>
4. <http://www.panorama.com.al/raporti-6-mije-te-vrare-gjate-diktatures-34-mije-te-burgosur/>
5. <http://gazeta-shqip.com/lajme/2012/10/04/berisha-nuk-bej-negotiata-me-ish-te-perndjekurit-rama-do-pazare/>



6. <http://gazeta-shqip.com/lajme/2012/10/10/qeveria-i-konverton-letrat-me-vlere-ne-leke-jo-sa-vlejne-ne-treg/>
7. <https://www.bbc.com/news/world-europe-20189444>
8. <http://www.gazetadita.al/kur-genc-ruli-raportonte-abuzimet-e-udheheqjes-komuniste-sa-mish-vaj-gjalpe-kafe-birra-lajthi-e-kikirike-konsumohej-ne-bllok/>
9. [https://www.washingtonpost.com/archive/politics/1994/07/03/albanian-court-sentences-last-communist-leader/e13ae275-75e2-4ed9-b331-f58cfa1ffbf/?utm\\_term=.e23547736b16](https://www.washingtonpost.com/archive/politics/1994/07/03/albanian-court-sentences-last-communist-leader/e13ae275-75e2-4ed9-b331-f58cfa1ffbf/?utm_term=.e23547736b16)
10. <https://www.refworld.org/docid/3ae6a7f30.html>
11. <https://bit.ly/2IexiLh>
12. <https://www.refworld.org/docid/3ae6a9ff80.html>
13. <http://albanianfreepress.al/en/news/2019/02/the-ghosts-of-the-former-secret-services-continue-to-haunt-today-society-133061/>
14. <http://www.panorama.com.al/daut-gumeni-dorehiqet-nga-autoriteti-per-hapjen-e-dosjeve-na-kane-vene-per-te-mos-zbuluar-asgje/>
15. <https://www.reporter.al/shqiperia-miraton-marreveshjen-per-gjetjen-e-eshtreve-te-te-zhdukurve-te-komunizmit/>
16. <http://www.radiandradi.com/dosjet-e-hapura-me-ligj-dokalojme-ne-dosje-te-mbyllura-nga-kastriot-dervishi/>
17. <http://www.panorama.com.al/drama-pa-katarsis-e-ligjit-te-dosjeve/>
18. <http://www.oranews.tv/article/te-gjithe-hetuesit-e-diktatures-shpetuan-duke-siguruar-certifikaten-e-pastertise/>
19. <http://abcnews.al/pd-ish-sigurimi-i-shtetit-ne-poste-te-larta-drejtuese-ne-shish/>
20. <http://www.bpb.de/geschichte/deutsche-geschichte/stasi/225357/albanien-deutschland-als-musterland>

## Ligje dhe vendime institucionale

1. AIDSSH. Raport vjetor 2018. <http://www.parlament.al/Files/Kerkese/Raport-Vjetor-ADISSH.pdf>
2. IIPP, Statistika mbi ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë; <http://ishperndjekurit.gov.al/al/statistika/>
3. ISKK, Statistika mbi ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë: [www.iskk.gov.al](http://www.iskk.gov.al)
4. Komiteti i Kombeve të Bashkuara kundër Torturës (CAT), Komenti i Përgjithshëm nr. 3, 2012, “Convention Against Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment”. <https://www.refworld.org/docid/5437cc274.html>
5. KLSH. Raport Auditimi i Performancës “Rehabilitimi i ish-të Përndjekurve Politikë në Periudhën e Tranzicionit”. Qershor 2016.
6. KLSH. Vendim Nr.86, datë 30/06/2016 Nr.883/15 Prot. “Për evadimin e materialeve të auditimit të performancës, rehabilitimi i ish-të përndjekurve politikë në periudhën e tranzicionit” [http://www.klsh.org.al/web/te\\_perndjekurit\\_politik\\_2592.pdf](http://www.klsh.org.al/web/te_perndjekurit_politik_2592.pdf)
7. KLSH. Raporti “Mbi zbatimin e buxhetit të Shtetit për vitin 2016”, 23 tetor 2017. [http://www.klsh.org.al/web/raport\\_per\\_zbatimin\\_e\\_buxhetit\\_te\\_shtetit\\_te\\_vitit\\_2016\\_3478.pdf](http://www.klsh.org.al/web/raport_per_zbatimin_e_buxhetit_te_shtetit_te_vitit_2016_3478.pdf)
8. Ligji nr. 7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politik” <http://www.ish.gov.al/wp-content/uploads/2014/04/Kapitulli3.pdf>
9. Ligji Nr.7748, Neni 2, datë 29.07.1993 “Për Statusin e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë politikë nga

Sistemi Komunist” <http://ishperndjekurit.gov.al/al/wp-content/uploads/2015/03/Ligj-stat.-e-te-perndjekurve-politike-7748-DT-04.08.1993.pdf>

10. Ligji Nr. 9831 datë 12.11.2007; Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 160 datë 3 dhjetor 2007 [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2007/PDF-2007/160-2007.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2007/PDF-2007/160-2007.pdf)
11. Ligji Nr. 94/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9831 datë 12.11.2007 Për dëmshpërblimet e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist” Fletorja Zyrtare; Viti 2014; fq.6164 [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2014/PDF-2014/135-2014.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/135-2014.pdf)
12. Ligji Nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” Fletorja Zyrtare; Viti 2015, fq.4671; [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2015/PDF-2015/88-2015.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/88-2015.pdf)
13. Ligji Nr. 57/2018 datë 13.09.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831 datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist” <http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20181016121821ligj%20nr%20%2057%20dt%20%2013%209%202018.pdf/>
14. LigjiNr.8043datë30.11.1995“Përkontrollinefigurësëzyrtarëve dhepersonavetëtjerëqëlidhenmembrojtjeneshtetitdemokratik” <http://80.78.70.231/pls/kuv/f?p=201:Ligj:8043:30.11.1995>
15. Ligji Nr. 9831, neni 6, datë 12.11.2007. “Masa e dëmshpërblimit për të burgosurit, të internuarit ose të dëbuarit”. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 160 datë 3 dhjetor 2007 fq.4 [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2007/PDF-2007/160-2007.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2007/PDF-2007/160-2007.pdf)

16. Ligji Nr.10034, datë 22/12/2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve” <https://bit.ly/2IhuAo8>
17. Rezoluta “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri” Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr.117, 15 nëntor 2006 [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2006/PDF-2006/117-2006.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2006/PDF-2006/117-2006.pdf)

### **CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

(Mos)Rehabilitimi i ish të përndjekurve politikë në procesin e drejtësisë tranzicionale (1991-2018) / Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë. – Tiranë : IDMC, 2019

60 f. : me foto ; 14.8\*21 cm.


Bibliogr.

**ISBN 978-9928-4482-3-1**

- 1.Persekutimi politik    2.Të burgosur politikë  
3.Të drejtat civile      4.Rehabilitimi

**343.848(496.5) “1991/2018”**

ISBN 978-9928-4482-3-1



9 789928 448231 >